



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 890/prot.
10

Tiranë, më 17.03.2020

VENDIM
Nr. 31, datë 17.03.2020

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES SË KOMISIONIT TË PËRHERSHËM “Mbi
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR
PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të nenit 3, 38, 46 e vijues ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 26, 32 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe pas diskutimeve sipas rendit të ditës në lidhje me propozimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregulloreve të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”.
2. Rregullorja e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, Mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngakohet për zbatimin e kësaj Rregulloreje Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

KRYETARI
ARBEN GJATA





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

RREGULLORE

**“MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË
PËRHERSHËM PËR PROMOVIMIN E PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Tiranë, 2020

Neni 1
Objekti i rregullores

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Përhershëm të Promovimit të Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë dhe përcakton kompetencat, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPPPA-së, si dhe të drejtat dhe detyrat e këtij organi në përputhje me kornizën ligjore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.


Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kritereve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor””, i ndryshuar.

Udhëzimin e Ministrit përgjegjës për arsimin nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistarve shtetërore të gradave shkencore dhe titujve akademik të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”

Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe ato të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 3
Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë

1. Organi kolegjial përgjegjës për dhënien e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe “Profesor” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, është Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, këtu e në vijim KPPPA ose Komisioni.
2. Përbërja e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT përcaktohet në Statutin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. KPPPA përbëhet nga 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë.
3. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT vetkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik nëpërmjet procesit të votimit, për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
4. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik mbajnë titullin “Profesor”.



Neni 4

Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT

1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, në mbledhjen e parë të tij, zgjedh, me votim të fshehtë, Kryetarin e Komisionit.
2. Zgjedhja bëhet me shumicën e thjeshtë të votave të të gjithë anëtarëve të tij, 50% + 1.
3. Mandati i Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT është 2 (dy) vjeçar.
4. Kandidati për Kryetar vetëkandidohet ose propozohet nga një ose më shumë anëtarë të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.

Neni 5

Detyrat e Kryetarit të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT

Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik kryen këto detyra:

- a. Drejton mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik;
- b. Organizon punën e Komisionit për ndjekjen dhe monitorimin, në vazhdimësi, të procesit të dhënies së titujve akademikë;
- c. Organizon punën për trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave në lidhje me procesin e dhënies së titujve akademikë;
- d. Përfaqëson KPPPA në marrëdhënie me të tretët;
- e. Informon, në mënyrë periodike, drejtuesit e njësive kryesore dhe Rektorin apo zv. Rektorin për Kërkimin Shkencor në UMT, për problematikat që janë konstatuar;
- f. Përcjell vendimet e KPPPA, me firmën e tij, në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre institucionale.
- g. I gjithë komunikimi shkresor zhvillohet përmes zyrave të protokollit të UMT-së dhe njësive kryesore përbërëse të saj.

Neni 6

Thirrja e mbledhjeve

1. Mbledhjet e KPPPA-së, si rregull, thirren nga Kryetari i tij.
2. Thirrja e mbledhjeve mund të bëhet edhe me kërkesë të 1/3 e anëtarëve të KPPPA-së, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje.
3. Lajmërimet për thirrjen e mbledhjeve, si rregull bëhen brenda 15 ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga 1/3 e anëtarëve, por, gjithsesi, të paktën 48 orë para datës së mbajtjes së mbledhjes.
4. Thirrja e mbledhjeve, bëhet me shkrim dhe/ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail). Njoftimi për mbledhje duhet të përmbajë rendin e ditës sipas çështjeve të cilat do të

diskutohet. Gjithashtu anëtarëve të KPPPA-së, duhet t'i dërgohen të gjitha materialet që do të diskutohen në mbledhje, si relacione, vlerësime, raporte, etj...

Neni 7 **Kuorumi**

1. Mbledhja e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, është e vlefshme kur janë të pranishëm 2/3 e anëtarëve të tij, pra jo më pak se 11 (njëmdhjetë) anëtarë, përveç rasteve kur kjo rregullore e parashikon ndryshe.
2. Kur në hapjen e mbledhjes nuk janë të pranishëm 11 (njëmdhjetë) anëtarë të KPPPA-së, Kryetari vendos thirrjen e mbledhjes në një ditë tjetër, të paktën 24 orë pas së parës.

Neni 8

Pjesëmarrja e anëtarëve në mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT

1. Anëtarët e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik marrin pjesë rregullisht në të gjitha mbledhjet e komisionit, me përjashtim të rasteve kur, për arsye objektive dhe me njoftimin paraprak të Kryetarit, nuk mund të jenë të pranishëm.
2. Anëtarët e Komisionit, në kryerjen e detyrave, duhet të jenë të paanshëm dhe të shmangin konfliktet e interesit në përputhje me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
3. Anëtarët e Komisionit, në ushtrim të funksionit të tyre janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin.

Neni 9

Sekretari i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT

1. Komisioni ka një sekretar/sekretare teknike, që miratohet që në mbledhjen e tij të parë, pas konstituimit. Sekretari propozohet nga Rektori i UMT-së dhe miratohet nga KPPPA-ja me shumicë të thjeshtë të votave (50%+1).
2. Sekretari merr pjesë në të gjitha mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, duke mbajtur proces-verbalin përkatës të mbledhjes.
3. Merr masa për krijimin e kushteve për mbarëvajtjen e mbledhjeve të KPPPA-së, si njoftimet, sallën e mbledhjeve, materialet e mbledhjeve, etj... si rregull me udhëzimin / miratimin e Kryetarit të KPPPA-së.
4. Mban dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjeve, si dhe zbardh vendimet e marra, si rregull jo me vonë se 2 (dy) ditë nga përfundimi i mbledhjes.
5. Administron dokumentacionin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik dhe kryen detyra brenda kompetencave të tij dhe fushës së aktivitetit.
6. Në rast mungese të tij, për arsye objektive, për një mbledhje të njoftuar, sekretari zëvendësohet nga anëtari më i ri në moshë i KPPPA-së.

Neni 10

Procedura e vlerësimit të dosjes së kandidatit

1. Komisioni për dhënien e titujve akademikë "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor", vlerëson dosjen e çdo kandidati që i paraqet, Senati Akademik, njësia kryesore pranë së cilës ai ka aplikuar për marrjen e titullit akademik "Profesor i Asociuar" ose "Profesor".
2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përcjelljes së dosjes nga Senati Akademik, Komisioni vlerëson nëse dosja e dorëzuar nga kandidati është e plotë apo jo, përsa i përket përmbajtjes së dokumenteve, duke caktuar për këtë qëllim 2 (dy) relator, nga përbërja e KPPPA-së. Relatorët, kur është e mundur, janë përfaqësues të të njëjtës fushë ose të fushës më të afërt me profilin që kandidati kërkon të marrë titullin përkatës.
3. Relatorët e caktuar nga Komisioni, në rast të evidentimit të mangësive të dokumenteve në dosjen e kandidatit, këtij të fundit i jepen 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë për të bërë plotësimet e nevojshme. Në rast se ato nuk plotësohen, dosja i kthehet kandidatit.
4. Në rast se dosja konsiderohet e plotë, Komisioni vijon menjëherë, në të njëjtën mbledhje, me ngritjen e jurisë për vlerësimin e dosjes.
5. Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, me titullin akademik "Profesor", të së njëjtës fushë ose fushave të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, të paktën, 2 (dy) duhet të jenë të ftuar nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, ose personalitete të spikatura, të së njëjtës fushë me atë të kandidatit, jashtë UMT-së.
6. Anëtarët e jurisë propozohen në Komision nga drejtuesi i njësisë kryesore, me miratimin e rektorit, nëpërmjet kërkesës së drejtuar KPPPA-së.
7. Numri i anëtarëve të propozuar është jo më pak se 8 (tetë), nga të cilët 5 (pesë) të jenë të brendshëm dhe 3 (tri) të jashtëm.
8. Data e nisjes së procedurës së vlerësimit të kandidatit konsiderohet data e ngritjes së jurisë. Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga data e nisjes së procedurës së vlerësimit, juria përgatit raportin e vlerësimit të kapaciteteve akademiko-didaktike e shkencore të kandidatit, në përfundim të të cilit jepet edhe rekomandimi për dhënien ose jo të titullit akademik. Raporti i vlerësimit i përcillet Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT.
9. Komisioni merr vendim përfundimtar për miratimin ose refuzimin e kërkesës së kandidatit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas marrjes së raportit të vlerësimit nga juria.
10. Në rastin e votimit të raportit të vlerësimit të jurisë dhe marrjes së vendimit përfundimtar, në mbledhje duhet të marrin pjesë, jo më pak se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të Komisionit dhe votimi është miratues kur votojnë "Pro", jo më pak se 8 (tetë) anëtarë të tij. Kur në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, votimi është miratues kur votojnë "Pro", jo më pak se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të tij.
11. Në rast refuzimi të kërkesës për fitimin e titujve akademikë nga Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, kandidati i lind e drejta të ripërsërisë kërkesën, pas

një periudhe kohore jo më të shkurtër se 2 (dy) vite nga data e paraqitjes së kërkesës së mëparshme, pranë drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 11

Konflikti i interesit dhe çështje e etikës

1. Në momentin kur anëtari i propozuar për pjesëmarrje në juri konstaton konflikt interesi, ka detyrimin të bëjë deklarinimin me shkrim të konfliktit të interesit dhe të kërkojë tërheqjen e tij.
2. Në rastin kur anëtari i jurisë heq dorë nga anëtarësia në juri, atëherë Komisioni e zëvendëson atë me njërin prej 3 (tri) anëtarëve të tjerë nga 8 (tetë) propozimet e paraqitura nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe të miratuara nga Rektori i UMT-së.

Neni 12


Votimi

1. Votimi në mbledhjet e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik bëhet i hapur, me përjashtim të rasteve kur cilësohet ndryshe në legjislacionin në fuqi, si dhe kur kërkohet nga Kryetari apo nga 1/3 (një e treta) e anëtarëve, të pranishëm në mbledhje.
2. Anëtarët e Komisionit, që janë të pranishëm në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore për të votuar, duhet detyrimisht të shprehin qëndrimin e tyre "pro" ose "kundër".
3. Kryetari i Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik voton i fundit.

Neni 13

Marrja e vendimeve

1. Komisioni merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes, me përjashtim të rasteve kur të paktën 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të pranishëm në mbledhje, vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për çështje që nuk janë në rendin e ditës.
2. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhje me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë rregullore apo në aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, në nivel kombëtar apo institucional.
3. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë përseritet e njëjta situatë, votimi shtyhet për t'u marrë në mbledhjen tjetër. Nëse pas votimit në mbledhjen e radhës sërish nuk arrihet shumica e cilësuar, anëtarët që votojnë kundër duhet të japin arsyetimin për votën kundër dhe lihet një kohë e mjaftueshme që problematika e ngritur në arsyetimin e votave kundër të zgjidhet.



Neni 14
Barazia e votave


1. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë dhe votimi është i hapur, vota e Kryetarit është vendimtare.
2. Në rast se votimi bëhet i fshehtë dhe votat janë të barabarta, kryhet një votim i dytë. Kur edhe në votimin e dytë ka barazi të votave, votimi shtyhet për mbledhjen tjetër. Në qoftë se në votimin e parë të mbledhjes tjetër ka përsëri një barazi votash, atëherë kryhet votim i hapur.

Neni 15
Procesverbali i mbledhjes

1. Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, ku bëhet një përmbledhje e të gjithë çështjeve të diskutuara në mbledhje, data dhe vendi i mbledhjes, anëtarët që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, si dhe forma dhe rezultati i votimeve.
2. Procesverbali mbahet nga sekretari dhe duhet t'u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fund të mbledhjes ose në fillim të mbledhjes pasardhëse. Pas miratimit procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari dhe të gjithë anëtarët e KPPPA-së të pranishëm në mbledhje.
3. Në rastet kur vetë Komisioni e shikon të arsyeshme dhe mbledhja është e ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.
4. Anëtarët e Komisionit, mund të kërkojnë që të shënohet në procesverbal fakti dhe arsyet e votimit kundër një vendimi të marrë Komisioni.

Neni 16
Zbardhja e vendimeve

1. Vendimet e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, zbardhen nga sekretari, jo me vonë se 2 (dy) ditë nga përfundimi i mbledhjes. Ato hartohen në 5 (pesë) kopje, të cilat nënshkruhen nga Kryetari. Një kopje e firmosur nga Kryetari, administrohet në arkivën e institucionit, tri kopjet e tjera, njëra ruhet në dosjen përkatëse të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik dhe dy të tjerat i adresohen, njëra Rektorit të institucionit dhe tjetra kandidatit që kërkon fitimin e titullit akademik, ndërsa 1 (një) kopje i dërgohet AKKSHI-të për regjistrimin e titullit.
2. Vendimet e Komisionit publikohen, në përputhje me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi.



Neni 17
Propozimet për ndryshimin e rregullores

Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik mund të bëjë propozime konkrete për ndryshimin e rregullores së funksionimit të tij, duke ia përcjellë ato Senatit Akademik të UMT-së, për miratimin përfundimtar.

Neni 18
Shpërblimi

Mënyra dhe masa e shpërblimit të Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT-së dhe sekretarit/sekretares së tij, miratohen nga Bordi i Administrimit, me propozimin e Senatit Akademik të UMT-së.

Neni 19
Interpretimi i Rregullores

Të drejtën e interpretimit të kësaj rregulloreje e ka Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Neni 20
Dispozita tranzitore

Kandidatët, të cilët kanë filluar procedurën për marrjen e titujve akademikë dhe kanë kaluar fazën e miratimit nga Këshilli i Profesorëve, e mbyllin procedurën për marrjen e titullit akademik sipas kritereve të legjislacionit në fuqi në momentin e dorëzimit të dosjes në Këshillin e Profesorëve. Këta kandidatë ndjekin procedurat e përcaktuara në këtë vendim për fazën përfundimtare në Komisionin për Promovimin e Personelit Akademik.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore miratohet paraprakisht me vendimin e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik në UMT dhe hyn në fuqi pas miratimit të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI I KOMISIONIT
Prof. Dr. ARBEN BABOÇI

